

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Valbona Sanxhaktari, në cilësinë e relatores, në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi kam vlerësuar se ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë për arsye si në vijim.

2. Në rastin objekt shqyrtimi, Komisioni ka hetuar pasuritë e përfituara me trashëgimi ligjore nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, por të krijuara nga nëna e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që ai ushtronte funksionin e gjyqtarit, funksion ky i mbajtur nga subjekti prej vitit 2005, për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që ai nuk ndodhej në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

2.1 Në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni ka tagrin që të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo *indicie* apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit hetimor të kryer në Komision. Në të kundërt të sa pretendon subjekti, Komisioni nuk kufizohet të bëjë hetimet e duhura për të verifikuar faktet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me dyshime mbi pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

3. Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të mëposhtme nga nëna e tij:

- a) llogarisë në BKT në vlerën 4.490.000 (katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, krijuar në vitin 2009;
- b) apartamentit me sip. 124.7 m², me vendndodhje në Tiranë, krijuar në vitin 2012, në vlerën 16.776.450 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Lidhur me mundësitë financiare të nënës për krijimin e pasurive nga viti 2009 deri në vitin 2012, gjatë hetimit dhe përgjigjeve në barrën e provës kanë rezultuar të dhëna dhe dokumentacion lidhur me të ardhurat e nënës: (a) nga shitja e apartamentit në vitin 2005; (b) të përfituara gjatë periudhës 2014 - 2015 nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor; (c) nga paga e saj si arsimtare deri në vitin 2015 dhe nga pensioni duke filluar nga viti 2015; (ç) nga interesat e bonove të thesarit të investuara në vitin 2009.

5. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim edhe të ardhurat e babait të tij të ndjerë, i cili para se të ndërronte jetë në vitin 2005 ia kishte lënë të ardhurat gruas së tij (Nsubjektit. Të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit të provuara nga dokumentacioni ligjor janë të ardhurat e tij nga punësimi që i perkasin viteve 1999 – 2005, ndërsa të ardhurat e tjera mbeten të paprovuara me dokumentacion provues ligjor sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

6. Në qëndrimin më garantist, pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës të dërguar nga Komisioni lidhur me pasuritë e krijuara nga nëna, të ardhurat e mësipërme mund ta çonin Komisionin vetëm në konkluzionin se mund të kenë qenë të mjaftueshme për të provuar vetëm burimin e ligjshëm të nënës së subjektit për investimin në bono thesari në vitin 2009 në shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë.

7. Përtej këtij konkluzioni, lidhur me investimin e nënës në pasurinë apartament banimi me sip. 124.7 m², në Tiranë, në vitin 2012, në vlerën 16.776.450 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, nëna e subjektit të rivlerësimit në të gjithë skenarët e mundshëm të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare.

8. Kjo sepse nëna e subjektit në këtë investim nuk ka përdorur për krijimin e kësaj pasurie apartamentin e banimit me sip. 124.7 m², në Tiranë, as vlerën prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh që ajo dispononte në bono thesari nga viti 2009, shumë kjo që mbeti e pandryshuar deri pas vdekjes së të ndjerës, nënës, dhe që u trashëguua më pas nga i biri, subjekti i rivlerësimit.

9. Sipas kontratës, ky apartament, likuiduar *cash* në zyrën noteriale nga blerësja, nëna e subjektit, te shitësit e kësaj pasurie, në një periudhë në të cilën ajo ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit dhe gjatë së cilës ajo nuk provon me asnjë dokumentacion ligjor provues apo financiar të këtë disponuar shumë 16.776.450 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, përdorur si burim krijimi për këtë pasuri.

10. Fakti që subjekti është shkëputur nga gjendja familjare me nënën e tij në datën 18.4.2012 (3 ditë pas blerjes së pasurisë apartament banimi nga nëna në Tiranë) tregojnë se qëllimi i vetëm ka qenë shmangia e tij nga deklarimi i kësaj pasurie të paluajtshme, për sa kohë që blerja e kësaj pasurie ishte rrethana e vetme e ndryshuar dhe gjithë rrethanat e tjera ishin të njëjta sipas deklarimeve të tij nga viti 2006 deri në vitin 2013 dhe se ai jetonte në Vlorë dhe në Tiranë në të njëjtën adresë banimi me nënën e tij.

11. Përveç sa më sipër, rezultoi e provuar se nëna e subjektit edhe pas blerjes së këtij apartamenti ka vijuar të jetojë në një shtëpi të marrë me qira në rrugën “****”, në Tiranë (sipas deklarimeve të subjektit në DPV, por edhe në ILDKPKI).

12. Gjatë hetimit administrativ deklaratimet kontradiktore të bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit apo edhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me përdorimin e mundshëm të këtij apartamenti nga nëna e tij nuk u konfirmuan nga informacionet e marra nga FSHU-ja, nga ku rezultoi se: (a) apartamenti i marrë me qira nga nëna e subjektit në rrugën “****” ka pasur konsum të rregullt të energjisë ndër vite edhe për vitet 2012 – 2019; (b) apartamenti me sip. 124 m², i blerë nga nëna e subjektit, znj. T. I., në datën 14.4.2012, për të cilin nëna e subjektit të rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare, nuk ka pasur konsum energjie prej momentit të blerjes së tij në vitin 2012 deri në muajin qershor 2019, kur ky apartament ka filluar të përdoret nga vetë subjekti i rivlerësimit, duke provuar në këtë mënyrë se ky apartament nuk është përdorur ndonjëherë prej nënës së subjektit.

13. Rrethana të tilla, në mënyrë indirekte, pa u konsideruar spekulative, informojnë mbi marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri të paluajtshme të nënës së tij, objekt hetimi administrativ, dhe mungesën e një marrëdhënieje të nënës së subjektit me këtë pasuri.

14. Për sa u ngritën dyshime dhe nuk u provua mundësia financiare për nënën e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, vlerësoj se rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ dhe të paprovuara nga subjekti në përgjigje të barrës së provës të tilla si:

- pamundësia financiare e nënës së subjektit, znj. T. I., për krijimin e pasurisë, apartament banimi me sip. 124.7 m², në Tiranë, përfitur në vitin 2012, në vlerën 16.776.450 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë;
- shpjegimet e subjektit nuk ishin bindëse mbi arsyet e investimit të nënës së tij në këtë pasuri të paluajtshme në një zonë preferenciale dhe me një çmim të konsiderueshëm, të cilin nëna edhe pse e ardoi, nuk e përdori për 7 vjet, pavarësisht investimit të kryer;

- pretendimi i subjektit për gjendjen e tij në kushtet e parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se ai nuk gjendej në asnjë prej rasteve të parashikuara nga ajo dispozitë¹;
- përpjekja e subjektit për të paraqitur një marrëdhënie të largët e jo të mirë me nënën e tij, pretendim i cili nuk mbështetet në faktin se ai rezultoi përfituesi i vetëm me trashëgimi i të gjitha pasurive të nënës së tij, pas vdekjes së të ndjerës në vitin 2019:

vlerësohen të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky apartament është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

15. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, arsye për të cilën kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.

Valbona SANXHAKTARI
Relatore/kundër

¹ “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.